



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Pristina - Municipality of Prishtina



Bazuar në Planin e aktiviteteve të Projektit “Këndi i Librave”, Komuna e Prishtinës, shpall:

KONKURS PROJEKTIMI

Për hartimin e projekt – propozimit arkitektonik “Këndi i Librave” në Prishtinë

1 mars – 22 mars 2016

Komuna e Prishtinës fton të gjithë të interesuarit e profilit të Arkitekturës dhe Dizajnit të Enterierit (kompani, arkitekt / dizajner i/e diplomuar), të konkurojnë për projekt-propozimin arkitektonik “Këndi i Librave” në sheshin “Zahir Pajaziti” dhe “Nëna Terezë” në Prishtinë, si pjesë e planit të aktiviteteve të projektit “Këndi i Librave”. Këndi i Librave është planifikuar të zhvillohet në sheshin “Zahir Pajaziti” dhe “Nëna Terezë” në Prishtinë ku shitësit e librave do të mund të shesin dhe promovojnë libra.

Të gjitha koncept projektet që do të konkurojnë në këtë konkurs, do të vlerësohen nga një juri profesionale. Procesi i përzgjedhjes do të bëhet nëpërmjet vlerësimit të Koncept Projekteve në bazë të përgjegjshmërisë së tyre, sipas kërkesave teknike dhe/ose estetike, duke aplikuar kriteret e vlerësimit, nën-kriteret, dhe sistemin e pikëve të caktuara nga juria profesionale. Pas vlerësimit të Koncept Projekteve, juria do të shpallë tre fituesit e këtij konkursi, të cilët do të shpërblehen me çmime fituese.

Për informacion më të detajuar ju lutem kontaktoni Zyrën e Prokurimit në Komunën e Prishtinës.

Shpalljen mund ta gjeni në:

<http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=113514>

